



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE PUBLIKIMIT

Nr. 4770 Prot.

Tiranë, më 23.07.2021


Lënda: Njoftim

Drejtuar: Të gjithë Autoriteteve/Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), sjell në vëmendje të autoriteteve/entëve kontraktore se referuar Ligjit Nr. datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" se, pas përfundimit të fazës së vlerësimit të ofertave duhet të kryejnë veprimet si më poshtë:

1. Krijohet dhe dërgohet për publikim nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE"), formulari i njoftimit paraprak të fituesit, duke ndjekur hapat si më poshtë:

Nëpunësi i autorizuar pasi hyn në sistem, duhet të klikojë tek skedari "Detyra të mbetura" dhe tek faza "**Kërkohet Ri-vlerësim**" duhet të zgjedhë "**Njoftim Fituesi**" për të kaluar në krijimin në sistem të njoftimit paraprak të fituesit.



Në këtë moment, në dritaren e shfaqur gjenerohet “Raporti i Klasifikimit Përfundimtar”. Për të vazhduar me krijimin e njoftimit paraprak të fituesit, nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë butonin “Tjetër”.

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK Prokurimi elektronik - Seksioni i Autoritetit Kontraktues

Kontrollo

Njoftimi i Fituesit
Plotesoni te gjitha fushat e kerkuara dhe klikoni Tjetër

6/9/2021 1:21:53 AM

Klasifikimi Përfundimtar

Objekti i procedurës së prokurimit: test e hapur e thjeshtuar me lote

I klasifikuar i par: ekonomik

Operatorët ekonomik të kualifikuar:

Operatori ekonomik	Vlera e ofruar	Arsye
economic5	200.000,00	
Economic1	300.000,00	

Operatorët ekonomik të kualifikuar:

Operatori ekonomik	Arsye e Kualifikimit

Faqe 1 nga 1

Tjetër

Më pas, do të shfaqet dritarja “Njoftim Fituesi”, ku duhet të plotësohet fusha “Fituesi” me anë të opsionit të kërkimit “look up” (butoni me shenjën e lupës) duhet të zgjidhet operatori i shpallur fitues nga komisioni i vlerësimit të ofertave, si dhe tek fusha “Vlera” duhet të vendoset oferta ekonomike pa TVSH.

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK Formulari

Njoftimi i Fituesit
Plotesoni te gjitha fushat e kerkuara dhe klikoni Tjetër

Profil/Perlodha

Procedure: test e hapur e thjeshtuar me lote

Procedurat: E hapur, e thjeshtuar

Tipi i Kontraktit: Hapëse

Fituesi: [Vlera e Fituesit] [Krijuar në]

Nuk ka te dhëna

Shto një fitues të ri...

Kontakte:

Njoftimi i Fituesit

Subjekti	Numri	Krijuar nga	Krijuar në	Modifikuar nga	Modifikuar në


Nuk ka te dhëna

Shto një rekord të ri...


Tjetër

Ndërsa, tek seksioni “Njoftimi i fituesit” klikoni tek butoni “Shto një rekord të ri” për të shtuar njoftimin paraprak të fituesit. Nëpunësi i autorizuar duhet të plotësojë fushën “Përshkrimi”, si dhe tek paneli “Dokumentet e Njoftimit”, me anë të opsionit “Bashkangjit”, duhet të ngarkojë në sistem njoftimin paraprak të fituesit, i cili do të botohet në Buletin e Njoftimeve Publike. Më tej, po në këtë dritare konfirmoni tek

opsioni “Aprovuar/Miraturar”, duke zgjedhur “Po” ose “Jo”. Në përfundim të këtij veprimi klikoni tek butoni “Tjetër”. Tashmë është krijuar njoftimi paraprak i fituesit.



Më pas, nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë butonin “Tjetër” dhe në dritaren që shfaqet duhet të klikojë butonin “Dërgo për publikim njoftimin”.



Në këtë moment, njoftimi paraprak i fituesit i krijuar në sistem nga nëpunësi i autorizuar është dërguar për publikim në APP.

Shpallja e njoftimit paraprak të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

Pas publikimit të njoftimit paraprak të fituesit autoriteti/enti kontraktor pret afatet e ankimimit.

Në rast se në përfundim të afateve të ankimimit nuk rezulton të ketë ankesa, autoriteti/enti kontraktor i dërgon operatorit ekonomik fitues me anë të opsionit “Kërkesa”, nga llogaria e anëtarit të KVO, kërkesën me përmbajtjen si më poshtë:

Duke iu referuar procedurës [_____], informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/ pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.


Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.


Pas nënshkrimit të kontratës, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit vijon me ngarkimin në sistem të njoftimit të lidhjes së kontratës duke klikuar Shko te “Njoftimi i Lidhjes së kontratës” dhe të ngarkojë formularin e njoftimit të lidhjes së kontratës në sistem.

-Në rast se ka ankesa, autoriteti/enti kontraktor duhet të ngarkojë në sistem formularin e njoftimit të fituesit (pas procesit të ankimimit), konkretisht:


Nëpunësi i autorizuar pasi hyn në sistem, te skedari “Detyrat e mbetura” do të shfaqet faza “Konfirmimi i Fituesit” dhe për të krijuar njoftimin e fituesit (pas procesit të ankimimit), duhet të klikojë butonin “Krijo një njoftim të ri Fituesi”.



Në këtë moment, tek skedari “Detyrat e mbetura” do të shfaqet faza “Njoftim Fituesi” për procedurën. Nëpunësi i autorizuar, pas kalon dritaren e gjenerimit të “Raporti i Klasifikimit Përfundimtar”, tek dritarja “Njoftim Fituesi” duhet të vendos operatorin ekonomik fitues të fusha “Fituesi” me anë të opsionit të kërkimit “look up”, si dhe të fusha “Vlera” duhet të vendosë oferta ekonomike pa TVSH të operatorit fitues. Më pas, tek seksioni “Njoftimi i fituesit” me anë të butonit “Shtro një rekord të ri” nëpunësi i autorizuar duhet të krijojë njoftimin e fituesit (pas procesit të ankimit).



Procesi i krijimit të njoftimit të fituesit (pas procesit të ankimit) duhet të përfundojë me dërgimin e tij në sistem për publikim nga nëpunësi i autorizuar, duke klikuar butonin “Publiko Njoftimin e Fituesit”.



Në këtë moment, njoftimi i fituesit pas procesit të ankimimit i krijuar në sistem nga nëpunësi i autorizuar është dërguar për publikim në APP.

Pas nënshkrimit të kontratës, nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të klikojë “Shko te Njoftimi i Lidhjes së Kontratës” dhe të ngarkojë formularin e njoftimit të lidhjes së kontratës në sistem, pasi të jetë publikuar Njoftimit i fituesit (pas procesit të ankimimit).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

